



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.12.1-2012-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË
ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Maj 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Beza Halilaj mbështetur nga Agron Fetiu (Udhëheqës i ekipit), Ariana Berisha-Rexhëbeqaj dhe Edona Abazi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	8
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	10
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	22
6 Konkluzioni i përgjithshëm	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP	25
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	27

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare (PVF-të) për vitin 2012 për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Unë do të doja të falënderoja Ministrin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i PVF-ve për vitin 2012 ishte ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me PVF-të.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pasqyrat Vjetore Financiare;
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit); dhe
- Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij. Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ana e ZAP-it. Raporti i AP-së përfshinë një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e pasqyrave financiare.

Opinionin e AP-së është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat vjetore financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (SINSA 400 Opinion i Pakualifikuar)

Konkluzioni i përgjithshëm

Niveli i punës së ndërmarrë nga ana e ZAP-it për të përfunduar auditimin e vitit 2012 është pasqyrim i drejtpërdrejtë i cilësisë së mjedisit të kontrollit të brendshëm të implementuar nga menaxhmenti. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Sistemi i kontrolleve të brendshme të MAPL-së është dizajnuar në mënyrë të duhur, por nuk ka funksionuar në mënyrë efikase në të gjitha rastet si duhet.

Ne ishim në gjendje të kemi siguri në funksionimin efektiv të kontrolleve menaxheriale në një numër fushash të llogarive, por kemi identifikuar edhe dobësi në disa fusha të

rëndësishme të menaxhimit financiar. Dobësitë janë të shpjeguara më detajisht më poshtë.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim ta mbështesin MAPL-në në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe rritjen e aspekteve tjera të aktivitetit operacional. Ne i kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimeve tona të bëra në vitin 2011- pozita aktuale është përmbledhur në Shtojcën II. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është që kërkohen veprime shtesë për t'i adresuar disa rekomandime të rëndësishme të vitit paraprak.

Rekomandimet tona kryesore janë si në vijim:

Menaxhmenti i MAPL-së duhet:

- Të sigurojë se plani i veprimit e përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar- dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësishme më të madhe;
- Në mënyrë sistematike t'i vlerësojë arsyet për nivelin e reduktuar të ekzekutimit të buxhetit në vitin 2012 dhe t'i përcaktojë opcionet praktike për përmirësimin edhe të kësaj por edhe të profilit të shpenzimeve përgjatë vitit. Kjo mund të përfshijë punën me komunat dhe organizatat tjera buxhetore; monitorimin proaktiv të niveleve të mundshme të shpenzimeve në nivelin e nën-kategorive; ndërlidhja me MF-në për t'i liruar fondet të cilat nuk pritet të shfrytëzohen dhe shqyrtimi i proceseve të planifikimit të buxhetit për t'u siguruar që ato janë të qëndrueshme;
- Të sigurojë që fondet për komunat të zotohen paraprakisht në mënyrë që projektet e dakorduara të mund të zbatohen në kohë dhe në linjë me kontratat. MAPL, duhet të vendosë monitorim efektiv për t'u siguruar që rrjedhat e parasë së gatshme të komunave përputhen me kërkesat e projektit dhe të sigurojë që komunat nuk kanë hyrë në kontrata para nënshkrimit të një Memorandumi të Marrëveshjes formale;
- T'i identifikojë arsyet për vonesat në kryerjen e projekteve dhe duhet të ndërmerren veprime për t'u siguruar që projektet janë kryer brenda afateve kohore të pritura. Penalet duhet të imponohen aty ku duhet për ta mbështetur këtë proces;
- T'i shikojë arsyet pse pagesa është bërë pa përmbushjen e kërkesave të kontratës dhe të zbatojë kontrolle të nevojshme për t'u siguruar që kjo situatë të mos përsëritet;
- Të sigurojë që regjistrat e pasurive janë harmonizuar në mënyrë formale me raportin e inventarizimit dhe që informatat e nevojshme të inkorporohen brenda regjistrat apo të mirëmbahen veçmas sipas nevojës.

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do t'i adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e MAPL-së të përgatisë PVF-të sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. ZAP është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF-ve dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF-të japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për MAPL. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testeve të përgjithshme. Kjo është bërë, për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjendet në Shtojcën II.

Ne kemi përfshirë të gjeturat e rëndësishme dhe të tjera më pak të rëndësishme, që dalin nga auditimi ynë. Për plotësinë ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të nëntë mujorit aty ku ishte e rëndësishme. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të rëndësishme- Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë, e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

Të tjera- Dobësitë e identifikuar në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësim në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasyshë pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në to. Ne gjithashtu konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshinë një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të tyre. Një numër i pikëve në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

PVF-të e MAPL-së janë në pajtim me kornizën ligjore për raportim financiar dhe Rr.F. nr.07/2011.

Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasyshë se PVF-të:

- Janë dorëzuar në MF - Thesar brenda afatit kohor me datën 31.01.2013;
- Janë përgatitur si kopje fizike edhe si elektronike;
- Janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar; dhe
- Janë dorëzuar në Thesar në gjuhën shqipe dhe serbe.

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

Konkluzioni i përgjithshëm

PVF-të e dorëzuara në Thesar me 31 Janar 2013 ishin të cilësisë së mirë. Vetëm një element - Pasqyra e Ekzekutimit të Buxhetit ka kërkuar përshtatje para auditimit.

Përshkrimi

Te Pasqyra e Ekzekutimit të Buxhetit, në buxhetin final të prezantuar nuk ishin përfshirë edhe donacionet në vlerë 47,713€. Prezantimi i saktë i ndarjeve buxhetore tek tabela e ekzekutimit të buxhetit.

Marrë parasysh atë më lartë - Deklarata e bërë nga ZKA dhe Zyrtari Kryesor Financiar se informatat në PVF janë të plota, të sakta dhe përmbajnë informatat e duhura, është vlerësim i drejtë.

2.3 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat vjetore financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (SINSA 400 Opinion i Pakualifikuar)

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Pavarësisht përpilimit të planit të veprimit nga MAPL për t'i adresuar rekomandimet e vitit 2011 – një numër i çështjeve të rëndësishme ende mbeten të adresohen.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2011 të MAPL-së ka rezultuar në 12 rekomandime kryesore. Deri në fund të auditimit për vitin 2012, 5 rekomandime janë adresuar plotësisht, 3 janë adresuar pjesërisht dhe tjerat nuk janë adresuar ende. Një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe shpjegimin se si janë adresuar ato, mund t'i shihni në Shtojcën II.

Të gjeturat dhe rekomandimet

1. Çështja - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura	Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar.
Rreziku	Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të brendshme në sistemet kyçe financiare kanë rezultuar- për shembull në: <ul style="list-style-type: none">• Mos efikasitet të vazhdueshëm organizativ dhe vlerë të dobët për para në fushën e shpenzimeve; dhe• Vonesa në përmirësimin e kontrolleve që kanë të bëjnë me menaxhimin e pasurive.
Rekomandimi 1	Menaxhmenti duhet të sigurojë se plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar- dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësishme të madhe.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Kjo mund, për shembull, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarra nga menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më të ulët.

Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Megjithëse, në disa aspekte, siç është ai i menaxhimit të buxhetit ende ka nevojë për përmirësim. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjat e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

Duke ndjekur këshillën tonë, Menaxhmenti i MAPL-së ka kryer një proces të vetëvlerësimit, i cili do të zhvillohet më tutje në të ardhmen me mbështetje nga Ministria e Financave. Procesi fillestar i vetëvlerësimit është një zhvillim pozitiv.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

Përderisa MAPL nuk ka kontroll të plotë mbi alokimet e buxhetit të saj apo në aspekte të ekzekutimit të buxhetit, mbetet potenciali për ngritjen e nivelit të përgjithshëm të ekzekutimit të buxhetit. Edhe nivelet e shpenzimeve janë reduktuar pasi që ekzekutimi faktik i buxhetit në krahasim me vitin 2010-11 poashtu është reduktuar.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për MAPL-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Burimet e Fondeve:	6,769,058	6,788,072	5,792,704	7,682,145	8,305,658
Granti i Qeverisë-Buxheti	6,769,058	6,740,358	5,752,550	7,680,745	8,239,812
Donacionet e Jashtme	-	47,713	40,154	1,400	65,846

Konsolidimi dhe themelimi i komunave të reja ka rezultuar në reduktimin e alokimit të buxhetit për MAPL-në.

Nga tabela vërehet se gjatë vitit 2012, MAPL ka shpenzuar 5,792,704€ ose 85% të buxhetit final. Ky është një nivel dukshëm më i ulët i ekzekutimit se sa që ishte në vitin 2011 (95%).

Një zvogëlim nga buxheti fillestar në buxhetin final për 28,700€ ishte bërë me vendimin e Qeverisë nr.06/2012 për funksionimin e fondit për kuadro dhe vendimi nr.04/101, për reduktimin e ndarjeve të reja buxhetore.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	6,769,058	6,788,072	5,792,704	7,682,145	8,305,658
Pagat dhe Mëditjet	699,919	779,542	696,535	726,375	610,831
Mallrat dhe Shërbimet	336,058	789,104	672,666	451,113	782,715
Subvencionet dhe Transferet	437,249	487,249	390,063	408,164	392,406
Investimet Kapitale	4,700,000	4,732,177	4,033,440	6,095,493	6,520,706
Rezervat	595,832	-	-	-	-

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Fillimisht, buxheti fillestar ka qenë 6,769,058€, ndërsa ai final 6,740,358 €. Ndryshimi në 28,700€ ka ardhur si rezultat i vendimeve të Qeverisë 6,769,058€+22800€-51500€=6,740,358€ (buxheti final)

Ndryshimet në mes të buxhetit fillestar dhe përfundimtar e reflektojnë alokimin e rezervave. Ekzistenca e rezervave është unike për MAPL-në, por ndikimi i alokimit të kësaj është bërë për ta rritur nën-shpenzimin kundrejt buxhetit.

Nën-shpenzimi kundrejt Pagave dhe Mëditjeve kryesisht e reflekton atë se me rishikimin buxhetor janë aprovuar mjete shtesë për ekipin përgatitor për Komunën e Mitrovicës. Por, ato nuk janë përdorur pasi që ekipi ka kaluar në Zyrën Administrative në Mitrovicën Veriore dhe është financuar veçmas.

2. Çështja - Ekzekutimi i Buxhetit jo si duhet - Prioriteti-i rëndësishëm

E gjetura Niveli i ekzekutimit të buxhetit është i ulët siç është shpjeguar në komentet rreth Tabelës 1 dhe Tabelës 2. Poashtu kemi vërejtur që ekzekutimi i buxhetit ka variruar në mënyrë signifikante në mes të nënkategorive – për shembull, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare nga 25,058€ në 61,198€, shpenzimet tjera nga 25,000€ në 50,069€, dhe në shpenzime të marketingut dhe blerje të mobiljeve, ku nga 33,000€ ishin shpenzuar 2,215€ dhe nga 35,000€ ishin shpenzuar 7,870€. Në tremujorin e fundit janë shpenzuar 55% nga totali i shpenzimeve. Ndërsa, vetëm për investime kapitale janë shpenzuar 63% të buxhetit përkatës.

Rreziku Ekzekutimi i dobët i buxhetit rezulton në shfrytëzim joefikas të burimeve në sektorin publik dhe reduktim të efektivitetit të planeve të një organizate buxhetore individuale. Shpenzimi i përqëndruar në muajt e fundit të vitit rrezikon shpenzim joefektiv të fondeve, ku përqëndrimi është më shumë në arritjen e nivelit të dëshiruar të shpenzimeve se sa në arritjen e rezultateve efektive.

Rekomandimi 2 Menaxhmenti duhet t'i vlerësojë në mënyrë sistematike arsyet për reduktimin e nivelit të ekzekutimit të buxhetit në vitin 2012 dhe t'i përcaktojë optionet praktike për përmirësimin e kësaj dhe profilit të shpenzimeve nëpër tërë vitin. Kjo mund të përfshijë:

- Punën me komunat për të siguruar që është shmangur çfarëdo mangësie potenciale në proceset e prokurimit;
- Punën me organizatat tjera buxhetore për t'u munduar të ndikohet në proceset e prokurimit për të promovuar procese më të ngjeshura të cilat i reduktojnë vonesat kohore dhe potencialin për vërejtje në process;

- Monitorimin proaktiv të niveleve të mundshme të shpenzimeve në nivelin e nën-kategorive, ndërlidhja me MF-në për t'i kthyer fondet të cilat nuk pritet të përdoren;
- Shqyrtimin e proceseve të planifikimit të buxhetit për t'u siguruar që ato janë të qëndrueshme.

3. Çështja - Evidentimi i shpenzimeve në kode të pasakta-Prioriteti- Të tjera

E gjetura Projekti "Përgatitja, shpërndarja dhe publikimi i materialeve para dhe pas mbajtjes së konferencës së tretë ndërkombëtare për vetëqeverisje lokale" në vlerë 10,505€, për nga natyra i takon kategorisë së mallrave dhe shërbimeve ndërsa është financuar nga kategoria e subvencioneve.

Rreziku Evidentimi i shpenzimeve në kategori të pasaktë rritë rrezikun që qëllimi i menduar i shpenzimeve të mos arrihet dhe potencialisht është në kundërtënie me rregullat financiare të cilat kërkojnë që fondet të shpenzohet për qëllimet e menduara. Poashtu, kjo e redukton efektivitetin e menaxhimit të buxhetit.

Rekomandimi 3 Menaxhmenti, duhet të sigurojë që kontrollet janë zbatuar për të siguruar që shpenzimet e planifikuara për subvencione dhe transfere janë shpenzuar vetëm në këto fusha.

4.3 Kërkesat e raportimit

MAPL, ka përmbushur kërkesat për raportim të jashtëm. Të gjitha raportet e kërkuara janë dorëzuar brenda afatit të caktuar kohor.

Përshkrim

MAPL, gjatë vitit 2012:

- Ka përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Ministri i MF-së;
- Ka përgatitur dhe ka dorëzuar me kohë Pasqyrat Nëntëmujore Financiare;
- Ka përgatitur dhe dorëzuar në ZAP planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit;
- Ka përgatitur dhe dorëzuar raportin vjetor të performancës për vitin 2011 brenda periudhës së caktuar kohore (me datën 14 Gusht 2012);
- Ka dorëzuar raportet mbi borxhet në MF;

-
- Ka përgatitur planin preliminar dhe final të prokurimit për vitin 2012, si dhe ka dorëzuar me kohë në APP;
 - Ka hartuar dhe dorëzuar në MF raportet e kontollit të brendshëm , duke përfshirë edhe vetëvlersimin; dhe
 - Ka raportuar në MF projektet kapitale me vlerë më të lartë se 10,000€, siç kërkohet me ligjin e buxhetit.

Rekomandimet

Ne, nuk kemi asnjë rekomandim në këtë fushë.

4.4 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

Edhe pse janë bërë përmirësime në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit, edhe më tutje mbeten disa mangësi në këtë fushë, si dhe në dhënien e subvencioneve dhe avanseve për udhëtime zyrtare.

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

MAPL, ka shpenzuar gjithsej 5,792,704€, prej tyre 4,376,623€ janë shpenzuar përmes procedurave të prokurimit.

Ky shpenzim ka për qëllim të përdoret për zhvillimin e kornizës ligjore, infrastrukturës rrugore dhe investime tjera kapitale në komuna.

Për investime infrastrukturore komunat konkurojnë për fonde në MAPL për tërë ose një pjesë të projektit. Kur komunat marrin fonde, arrihet një marrëveshje mirëkuptimi me MAPL-në. Në të shumtën e rasteve, kjo parasheh që procedurat e prokurimit dhe mbikëqyrjes për to t'i realizojnë komunat, ndërsa investimet e realizuara pas finalizimit bëhen pasuri e komunës.

Komunat duhet të kompletojnë dokumentacionin, si: (kontratat, vendimet e komisionit mbikëqyrës, raportet mbi kryerjen e punimeve, faturat origjinale, etj). Pas kësaj, MAPL ekzekuton pagesën direkt te Operatorët Ekonomik (OE) të kontraktuar.

4. Çështja - Financimi i projekteve komunale me mangësi- Prioriteti - I rëndësishëm

- E gjetura** I kemi identifikuar dy projekte ku fondet për financimin e tyre, komunat nuk i kanë zotuar ashtu siç është bërë pajtimi me MAPL-në. Këto kanë të bëjnë me:
- Komuna e Gjilanit „Ndërtimi i rrugës në Shillovë faza e dytë“.
- Zotimi i mjeteve për bashkëfinancim nga MAPL është bërë në Maj 2012, ndërsa komuna ka hyrë në kontratë në prill 2012.
- MAPL e ka kryer pagesën edhe pse komuna ende nuk kishte përfunduar pjesën e pagesës prej 184,155€, pavarësisht faktit që fondet e MAPL-së paguhen vetëm pasi të jenë bërë të gjitha pagesat e komunës.
- Në projektin “Ndërtimi i pikave mbledhëse dhe furnizimi me kontejnerë” në shumë prej 133,362€, komuna nuk e ka përmbushur kërkesën për zotim të fondeve. Projekti i planifikuar të përfundojë në vitin 2012, nuk është kryer. Pavarësisht kësaj, MAPL i ka bërë pagesat në shumën e caktuar për bashkë-financim.
- Rreziku** Bërja e pagesave për komunat pa arritur të bëhet bashkë-financimi i plotë mund të rezultojë në projekte të pakryera dhe shfrytëzim joefektiv të parasë publike. Kur MAPL hynë në marrëveshje me komunat pa fonde të zotuar paraprakisht, rritë rrezikun që komunat të mos mund t'i financojnë projektet. Kjo, prap mund të rezultojë në projekte të pakryera dhe shfrytëzim joefektiv të parasë publike.
- Rekomandimi 4** Menaxhmenti i MAPL-së duhet që, paraprakisht të sigurojë zotimin e fondeve buxhetore për komunat në mënyrë që projektet e dakorduara me marrëveshje të mund të realizohen në linjë me kontratat e arritura dhe me kohë. MAPL, duhet të vendosë monitorim efektiv për të siguruar që rrjedha e parasë së komunës përputhet me kërkesat e projektit dhe të sigurojë që komunat nuk hyjnë në kontrata para se të nënshkruhet një Memorandum i Marrëveshjes formale.

5. Çështja - Vonesa në realizimin e punimeve - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Në kontratën “Ndërtimi i trotuarit Kllokot-Radivojc” në vlerë 75,000€, afati për përfundimin e punimeve ishte përcaktuar 22 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës, ndërsa projekti ishte vonuar 102 ditë.

Në kontratën “Asfaltimi i rrugës në Komunën e Ranillugut” në vlerë 140,654€, afati për përfundimin e punimeve ishte 42 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Kontrata është nënshkruar me 02 Gusht 2012, në fillim të vitit 2013 punimet nuk kishin përfunduar ende.

Për më tepër, në lidhje me këto vonesa ndaj punëkryesve nuk ishin vendosur masa për aplikimin e penaleve, përveç te projekti i parë në të cilin ishin aplikuar penale për vetëm 13 ditë por jo për gjithë vonesën.

Rreziku Vonesat në realizimin e punimeve rrisin mundësinë që kryerja e projekteve të mos i përmbushë specifikacionet e kontratës dhe do të ketë ndikim negativ në nivelin e ekzekutimit të buxhetit. Dështimi për të aplikuar penale për vonesa do të bëjë precedent përmes së cilit kontraktorët mund të mos e konsiderojnë përmbushjen e datave si një synim të rëndësishëm për t’u arritur.

Rekomandimi 5 Menaxhmenti duhet t’i identifikojë shkaktarët për vonesat në kryerjen e projekteve dhe marrjen e veprimeve për t’u siguruar që projektet të përfundohen brenda afateve kohore të pritshme. Penalet duhet të zbatohen ku ka nevojë për ta mbështetur këtë proces.

6. Çështja - Ndryshimi i pozicionit në faturë nga raporti i pranimit të mallit - Prioriteti - Të tjera

E gjetura Te lënda “Furnizim me inventar” në vlerë 10,005€, pozicioni “Garniturë për zyre” kemi vërejtur që artikujt e prezantuar në faturë dhe fletëdërgesë, nuk përputhen me raportin e pranimit dhe me kontratë. Kontrolli i menduar për të bërë krahasimin në mes të artikujve të pranuar dhe atyre të kërkuara nuk është aplikuar.

Rreziku Dështimi për ta aplikuar kontrollin e pritshëm të artikujve të pranuar rritë rrezikun e mospranimit të artikujve për të cilët është paguar apo pranimin e mallrave të cilësisë së ulët.

Rekomandimi 6 Menaxhmenti duhet të shtojë kontrole të mbikëqyrjes shtesë në proces për t’u siguruar se artikujt e pranuar janë ata që janë kërkuar dhe faturuar.

7. Çështja - Ekzekutim i pagesës pavarësisht që specifikacionet e kontratës nuk janë përmbushur - Prioriteti - Të tjera

- E gjetura** Në kontratën “Asfaltimi i rrugës Ruhot-Turbonoc-Staradan”, ekzistojnë ndryshime në mes të raportit përfundimtar të punëve të kryera dhe specifikacionit teknik të caktuar me kontratë. Për shembull, sasia e punës së paraparë për tu kryer ishte 2,040 m³, kurse ishin kryer vetëm 1,640 m³. Vlera e punëve të pakryera është (1,600€). Përkundër kësaj, MAPL ka ekzekutuar pagesën pa kërkuar informacion lidhur me këtë situatë.
- Rreziku** Pagesat e punëve të pa realizuara janë potencialisht parregullsi. Kur puna nuk është e kryer ka rrezik që të kërkohen fonde shtesë për ta kryer kontratën.
- Rekomandimi 7** Menaxhmenti duhet t’i rishikojë arsyet pse një pagesë është bërë pa u përmbushur kërkesat e kontratës për t’u siguruar që kjo situatë të mos përsëritet.

4.4.2 Shpenzimet tjera

Përshkrim

MAPL, gjatë vitit 2012 kishte shpenzuar gjithsej 337,753€ në blerjet tjera. Këto shpenzime, nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit dhe kryesisht përfshijnë: blerjen e materialit zyrtar, karburanteve, shpenzime për udhëtime zyrtare, pagesa për komunalit, etj.

8. Çështja - Mangësi në kontrolle në lidhje me udhëtimet zyrtare - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Vizita në SHBA në vlerë 11,290€ nuk është mbështetur paraprakisht nga ftesa dhe agjenda formale, dhe vizita në Slloveni prej 4,616€, si ajo më lart nuk ka pasur ftesë. Tarifa e mëditjes prej 117€ është tejkualuar pasi janë paguar 137€, si dhe dy gazetarë të RTK-së ju kanë bashkëngjitur udhëtimit me shpenzimet e MAPL-së (1,000€). Nuk ka rregullore të brendshme që i rregullojnë shpenzimet e tilla. Gjithashtu, në këto raste ka pasur vonesë në mbylljen e avansit në kohëzgjatjen prej 60 ditë në njërin dhe 35 ditë në tjetrin.

Rreziku Mungesa e bazës formale për udhëtime jashtë vendit dhe mungesa e qartësisë rreth atyre që duhet të përfshihen dhe paguhen nga MAPL, mund të rezultojë në shfrytëzim joefektiv të fondeve publike. Vonesat në mbylljen e avanseve rrisin rrezikun e mos kthimit të mjeteve të mbetura.

Rekomandimi 8 Udhëtimet zyrtare duhet të financohen nëse mbështeten nga një rast i fuqishëm i punës zyrtare që e arsyeton qëllimin e udhëtimit. Duhet të miratohen rregullore që i specifikojnë obligimet e MAPL-së ndaj stafit të përfshirë në udhëtime zyrtare që nuk është i MAPL-së. Kontrollat që kanë të bëjnë me avanset duhet të shqyrtohen dhe të ngritet niveli i tyre aty ku ka nevojë.

4.4.3 Kompensimet (Pagat dhe Mëditjet)

Përshkrimi

Gjatë vitit 2012, numri mesatar i të punësuarve ishte 125 punonjës në krahasim me buxhetin e planifikuar për 141 punonjës. Kjo e reflekton vendimin e qeverisë mbi themelimin e Zyrës Administrative në Mitrovicën Veriore, ku një pjesë e stafit të Ministrisë kanë kaluar në këtë zyrë. Pagat dhe Mëditjet janë paguar përmes sistemit të

centralizuar. Kontrollat që operojnë lokalisht nga MAPL kanë të bëjnë me autorizimin e Payroll-it, një shqyrtim i variancave dhe harmonizimeve të brendshme. Testimet tona kanë shpalosur një mangësi për sa i përket gradimeve dhe koeficientëve, por me këshillat tona kjo çështje është përmirësuar nga ana e MAPL-së.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Subvencionet janë dhënë për përfituesit publik dhe jo publik në vitin 2012.

Të gjeturat dhe rekomandimet

9. Çështja - Anashkalimi i marrëveshjeve për subvencione - Prioriteti - Tjetër

E gjetura	Te projekti i "Gjuhësisë për regjionin e Gjilanit (Anamorava)" në vlerë 9,400€, përfituesi i subvencionit nuk i është përmbajtur marrëveshjes së përcaktuar për kohëzgjatjen e aktiviteteve dhe dorëzimin e raporteve në ministri.
Rreziku	Dështimi në përmbushjen e marrëveshjeve të përcaktuara për dhënien e subvencioneve rritë rrezikun që subvencionet e paguara të mos arrijnë objektivën e përcaktuar.
Rekomandimi 9	Menaxhmenti duhet t'i shqyrtojë kontrollat ekzistuese që kanë të bëjnë me subvencionet, dhe të përcaktojë nëse mund të ndërmerren veprime shtesë për të siguruar arritjen e veprimit të dakorduar- kjo mund të përfshijë pagesë në faza që e reflektojnë pranimin e raporteve të kërkuara, etj.

4.5 Pasuritë

Edhe pse MAPL ka bërë inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive në fund të vitit sipas kërkesave të Udhëzimeve Administrative, problem mbetet evidentimi jo i plotë i pasurive brenda MAPL-së duke theksuar kështu një dobësi të vazhdueshme në menaxhimin e pasurive.

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik.

Projektet e investimeve kapitale të financuara nga MAPL nëpër komunat përkatëse janë regjistruar në regjistrat e kontabël të komunave. MAPL poashtu, i mirëmbanë pasuritë e veta.

Udhëzuesi kryesor në këtë fushë është U.A nr.21/2009- mbi Regjistrimin dhe Menaxhimin e Pasurive Qeveritare.

Të gjeturat dhe rekomandimet

10. Çështja - Regjistri jo i plotë i pasurisë - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Përderisa njehsimi fizik (inventarizimi) i pasurive është bërë për vitin 2012, nuk është bërë harmonizimi në mes të inventarizimit dhe regjistrit të pasurive siç kërkohet me U.A. Për më tepër, regjistri i përgjithshëm i pasurive (RPP) nuk i përmban të gjitha elementet që kërkohen me U.A.nr.21/2009. Për shembull, mungojnë barkodi dhe numri serik.

Poashtu e kemi identifikuar një pasuri, ku nuk ekzistojnë dokumente që e mbështesin blerjen e pasurisë (TV Sony 37 M).

Rreziku Dështimi për ta harmonizuar regjistrin e pasurive dhe raportin e inventarizimit mund të rezultojë në mos përfshirjen e tyre në regjistrin e pasurive dhe në mos menaxhimin efektiv që çon në vjetërsim/humbje etj. Të dhënat jo të plota mbi pasuritë, potencialisht mund të çojnë në vështirësi në identifikimin/lokacionimin e pasurive të tilla, që prapë çojnë në rrezikun e vjetërsisë/humbjes/ kontesteve rreth pronësisë.

Rekomandimi 10 Menaxhmenti, duhet të sigurojë se regjistrat e pasurisë janë harmonizuar formalisht në raportin e inventarizimit dhe që të gjitha informatat janë inkorporuar brenda regjistrit apo janë mirëmbajtur veçmas ashtu si duhet.

4.6 Trajtimi i borxheve

Konkluzioni i përgjithshëm

MAPL, në krahasim me periudhat më herët ka treguar progres për sa i përket trajtimit të borxheve. Përderisa vitin e kaluar obligimet në fundvit ishin 52,215€, në fund të vitit 2012 ato ishin 3,200€. Ngjajshëm me organizatat tjera, ka obligime tjera të njohura të cilat ne mendojmë se duhet të shpalosen në PVF në dobi të lexuesit të llogarisë.

Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2012 ishte në shumë prej 3,200€. Obligimet e pa kryera, kryesisht kanë të bëjnë me shpenzime të reprezentacionit, dhe një blerje për investime kapitale.

Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2013. Sikur edhe me shumicën e organizatave buxhetore, ka obligime të njohura për të cilat udhëzimet e PVF-ve nuk kërkojnë që këto të përfshihen në llogari.

Rekomandim

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzioni i përgjithshëm

MAPL, ka një sistem funksional të auditimit të brendshëm si segment i rëndësishëm i kontrolleve në përgjithësi. Komiteti i auditimit dhe NjAB janë funksional dhe kanë operuar në bazë të planit dhe përgjegjësive të caktuara. Megjithatë raportimi në NJQHAB duhet të përmirësohet.

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu ndaras. Ne e marrim parasyshë fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit. Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit.

MAPL, ka të themeluar NjAB, që përbëhet nga Drejtori i Auditimit të Brendshëm dhe një zyrtar.

NjAB ka përgatitur një plan vjetor dhe strategjik të auditimit për 2011-2013.

Për vitin 2012, Auditori i Brendshëm kishte planifikuar pesë auditime të rregullta si dhe auditim sipas kërkesave (auditimet ad-hoc). Këtë e kishte bërë në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe prioriteteve, duke e fokusuar auditimin në disa fusha të ndryshme.

NjAB, gjatë vitit ka hartuar raporte tre mujore, si dhe raportin vjetor për auditimet e kryera dhe aktivitetet e AB-së. Të gjitha raportet e auditimit janë përcjellë me gjetje dhe rekomandime.

Gjatë vitit, komiteti kishte mbajtur gjithsej katër takime të rregullta, ku është analizuar puna e NjAB-së si dhe implementimi i rekomandimeve të dhëna.

11. Çështja - Mos raportimi me kohë në NjQHAB

- E gjetura** Raportet e auditorit të brendshëm të tremujorit të parë dhe të dytë nuk janë dorëzuar me kohë në NjQHAB, megjithatë janë përfshirë në tremujorin e tretë.
- Rreziku** Mos raportimi me kohë në NjQHAB rritë rrezikun që veprimet e kërkuara të mos miratohen dhe të mos adresohen.
- Rekomandimi 11** NJAB duhet ta vë theksin në dorëzimin me kohë të raporteve në NjQHAB, respektivisht 15 ditë pas përfundimit të çdo tremujori.

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë i përgjithshëm e reflekton shqyrtimin tonë të kontrolleve që kanë të bëjnë me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollet dhe Sistemin e Auditimit të Brendshëm. Kjo mund të përmblihet si:

Sistemet e kontrolleve të brendshme në MAPL janë mirë të dizajnuara, por nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive në të gjitha rastet.

PVF-të e MAPL-së janë në linjë me kornizën ligjore për raportim financiar dhe Rregullën Financiare nr. 07/2011. PVF-të e dorëzuara në Thesar më 31 janar 2013 ishin të cilësisë së mirë. Vetëm një element i Pasqyrës së Ekzekutimit të Buxhetit kërkonte përshtatje gjatë auditimit. MAPL, i ka përmbushur kërkesat për raportim të jashtëm. Raportet janë dorëzuar brenda periudhës së kërkuar.

Pavarësisht zbatimit të një plani të veprimit nga MAPL për t'i adresuar rekomandimet e 2011 – një numër i rëndësishëm i tyre mbetet për t'u adresuar.

Përderisa MAPL nuk ka kontroll të plotë në alokimin e buxhetit apo aspekte të ekzekutimit të buxhetit, mbetet potenciali për ta ngritur nivelin e përgjithshëm të ekzekutimit të buxhetit. Edhe pse nivelet e shpenzimeve janë reduktuar që nga viti 2010, ekzekutimi faktik i buxhetit poashtu është reduktuar.

Edhe pse janë bërë përmirësime në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit, ende ka mangësi në këtë fushë e poashtu edhe në dhënien e subvencioneve dhe avanseve për udhëtime zyrtare.

Edhe pse MAPL ka bërë inventarizim dhe vlerësim të pasurive në fund të vitit, ashtu si kërkohet nga Udhëzimet Administrative, sfidë mbetet regjistrimi jo i plotë i pasurive brenda MAPL-së, duke e theksuar një dobësi të vazhdueshme në menaxhimin e pasurive.

Kur bëhet krahasimi me periudhat e mëhershme, MAPL ka treguar progres në trajtimin e borxheve. Përderisa në vitin paraprak, obligimet në fund të vitit ishin 52,215€, kah fundi i vitit 2012 ato ishin 3,200€. Si edhe me organizatat tjera, ka obligime të njohura të cilat mund të shpalosen në PVF, në dobi të lexuesit të llogarive.

MAPL, ka një sistem funksional të auditimit të brendshëm si segment i rëndësishëm i kontrolleve në përgjithësi. Komiteti i auditimit dhe NjAB janë funksional dhe kanë operuar në bazë të planit dhe përgjegjësive të caktuara. Megjithatë, raportimi në NJQHAB duhet të përmirësohet.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionit i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionit i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
Pasqyrat Financiare	Shpalosja në pasqyrat financiare. Raportimin vjetor të përformancës brenda periudhës së caktuar kohore	Po		
Shpenzimet	<p>Kryerjen e obligimeve ndaj OE-ve në kohë të caktuar.</p> <p>Shtimin e kontrolleve me synim që punimet në projekte të realizohen brenda afatit kohor të përcaktuar.</p> <p>Planifikimi, disponimi dhe zotimi i mjeteve buxhetore para çdo marrëveshje kontraktuale për realizimin e projekteve.</p> <p>Shtimin e kontrolleve në vlerësimin e tenderëve, si dhe sigurimin se antarët e komisionit përkatës trajtojnë kriteret e kërkuara.</p>	Po		<p>Nuk janë marrë masa.</p> <p>Nuk janë marrë masa.</p>
Shpenzimet tjera	<p>Dokumentim i cili përcakton qëllimet dhe arsyet për pjesëmarrjen e stafit jo shërbyes civil në përbërje të delegacionit të paguar me fondet e BKK-së.</p> <p>Mbylljen e avanseve nga udhëtimet zyrtare mbrenda afatit kohor.</p>			<p>Nuk janë marrë masa</p> <p>Nuk janë marrë masa</p>

Pagat dhe Mëditjet	Koeficientët e pagës në kontratë të jenë në përputhje me gradën (koeficientin) e përcaktuar në sistemin e pagesave (Payroll) si dhe ndryshimet në koeficient të aprovohen nga MAP-i.	Po		
Subvencionet dhe Transferet	Realizimi i subvencioneve të kaloj përmes procedurave të aprovimeve. Subvencionet planifikohen në pajtueshmëri me kërkesat dhe nevojat si dhe kriteret për dhënien e tyre hartohen për të siguruar se dhënia e subvencioneve bëhet vetëm për kategoritë e përcaktuara me kornizë.	Po Po		
Pasuritë	Se regjistrat e pasurisë janë të plotë dhe të sakta. Të gjitha pasuritë me vlerë mbi 1,000€ të evidentohen në regjistrin kontabël (SIMFK). Harmonizimin e të dhënave midis regjistrit të përgjithshëm të pasurisë dhe raportit të inventarizimit, në mënyrë që të gjenden diferencat si dhe të merren masat e nevojshme për azhurnimin e tij.	Po		Nuk janë marrë masa
Sistemi i Kontrollit të Brendshëm			Pjesërisht në disa fusha.	
Trajtimi i Borxheve	Parashikim më të mirë dhe monitorim të vazhdueshëm të fondeve të përcaktuara për kategori të shpenzimeve	Po		
Auditimi i Brendshëm	Implementimin e rekomandimeve nga NjAB, si dhe realizimin e planit nga kjo njësi.	Po		